



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.927/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevci kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Dragashit Arijeta Skeraj nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Dragashit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.927/2021 i datës 04.11.2021 paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Dragashit Arijeta Skeraj nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Dragashit më të cilën ka kërkuar korrigjimin e bartjes së votave në vendvotimin 05244A/01D.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Dragashit Arijeta Skeraj nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Dragashit, në të cilën pretendon se në vendvotimin 0522A/01D në fshatin Buçe në Dragash, ka ndodhur një gabim teknik, ku këtë ia ka konfirmuar edhe kryekomisioneri Brendi Berisha ku votat e kandidatit me nr. 3 Arjeta Skeraj janë bartur te nr. 2 Naser Murtezaj.

Si dëshmi ka bashkangjitur një bisedë në Viber.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Dragashit Arijeta Skeraj nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në

Prishtinë, dega në Komunën e Dragashit, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet korrigjimi e bartjes së votave në vendvotimin 0522A/01D në Dragash.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se nuk ka pasur bartje të saktë të votave në mes të kandidatëve të Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete e cila do ta vërtetonte pretendimin e saj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.927/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesues i Panelit**  
Adnan Konushevc



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.